

**Važna napomena:** Prevod ovog propisa, odnosno akta sa srpskog jezika na albanski jezik, omogućila je Misija Organizacije za evropsku bezbednost i saradnju u Republici Srbiji (dalje: Misija OEBS u Srbiji) sa ciljem da se pripadnicima i pripadnicama nacionalne manjine, čiji je jezik u službenoj upotrebi u Republici Srbiji, omogući da se na svom jeziku i pismu obaveste i upoznaju sa sadržinom teksta propisa, odnosno akta koji je predmet ovog prevoda.

Misija OEBS u Srbiji posebno napominje da je isključivo i jedino pravno-relevantan i merodavan tekst propisa, odnosno akta (koji je predmet prevoda u ovom dokumentu) koji je objavljen na srpskom jeziku, u skladu sa i shodno propisu koji uređuje objavljivanje zakona i drugih propisa i akata u Republici Srbiji.

Za potrebe prevoda ovog propisa Misija OEBS u Srbiji angažovala je kompaniju Eurotranslate d.o.o. koja je u celosti, i u svemu prema pravilima struke, odgovorna i garantuje za jasnoću, preciznost, istinitost i tačnost izvršenog prevoda na albanski jezik. Misija OEBS u Srbiji ni po jednom osnovu nije odgovorna i ne garantuje za jasnoću, preciznost, istinitost i tačnost izvršenog prevoda.

**Shënim i rëndësishëm:** Përkthimin e kësaj dispozite, respektivisht akti nga gjuha serbe në gjuhën shqipe, e ka mundësuar Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian në Republikën e Serbisë (në tekstin e mëtejme: Misioni i OSBE-së në Serbi) me qëllim që pjesëtarëve dhe pjesëtareve të pakicës kombëtare, gjuha e të cilëve është në përdorimi zyrtar në Republikën e Serbisë, t'ua mundësojë që në gjuhën dhe shkrimin e tyre të informohen dhe të njihen me përmbajtjen e tekstit apo dokumentit, i cili është objekt i këtij përkthimi.

Misioni i OSBE-së në Serbi, në veçanti tërheq vërejtjen se teksti i rregullores, është ekskluzivisht teksti i vetëm ligjor-relevant dhe kompetent, respektivisht i aktit (i cili është objekt i përkthimit në këtë dokument), i cili është botuar në gjuhën serbe, në përputhje me dhe në pajtim me dispozitën që përcakton shpalljen e ligjit dhe dispozitave dhe akteve tjera në Republikën e Serbisë.

Për nevojat e përkthimit të kësaj dispozite, Misioni i OSBE-së në Serbi ka angazhuar kompaninë Eurocontract sh.p.k. e cila në tërësi, dhe sipas të gjitha rregullave të profesionit, është përgjegjëse për qartësinë, precizitetin, vërtetësinë dhe saktësinë e përkthimit të bërë në gjuhën shqipe. Misioni i OSBE-së në Serbi për asnjë arsye nuk është përgjegjës dhe nuk garanton për qartësinë, precizitetin, vërtetësinë dhe saktësinë e përkthimit të bërë.

Në bazë të nenit 62, paragrafi 1, pika 15) të Ligjit mbi Këshillat Kombëtare të pakicave kombëtare („Gazeta Zyrtare e RS”, nr. 72/09, 20/14 – vendimi i GJ.K. dhe 55/14)

Komisioni Zgjedhor Republikan, në mbledhjen e mbajtur më 26 gusht 2014, miratoi

**UDHËZIMIN**  
**për zbatimin e zgjedhjeve të drejtpërdrejta për anëtarë të Këshillave Kombëtare të pakicave kombëtare**

**"Gazeta Zyrtare e RS", nr. 89, e datës 26 gusht 2014**

**I. DISPOZITA HYRËSE**

Neni 1.

Me këtë Udhëzim rregullohet më për së afërmi procedura për zbatimin e zgjedhjeve të drejtpërdrejta të anëtarëve të Këshillave Kombëtare të pakicave kombëtare (në tekstin e mëtejme: zgjedhjet).

**II. ORGANET DHE TRUPAT PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE**

Neni 2.

1) Organet për zbatimin e zgjedhjeve janë komisioni Zgjedhor republikan dhe komisionet zgjedhore.

**Komisioni Zgjedhor Republikan**

Neni 3.

(1) Komisioni Zgjedhor Republikan (në tekstin e mëtejme: Komisioni) kryen detyrat që janë të përcaktuara me Ligjin për Këshillat Kombëtare të pakicave kombëtare dhe me këtë udhëzim.

(2) Komisioni mund ta autorizojë anëtarin e vet ose zëvendësin e anëtarit (në tekstin e mëtejme: Koordinator) që në rrethin administrativ dhe qytetin e Beogradit, të kryejë veprime të caktuara në emër të Komisionit që kanë të bëjnë me organizimin dhe përgatitjen e zgjedhjeve.

**Trupat punuese të Komisionit**

Neni 4.

(1) Për ofrimin e ndihmës teknike në organizimin e zgjedhjeve, Komisioni formon grupe punuese të Komisionit (në tekstin e mëtejme: trupat punuese).

(2) Trupi punues formohet për territorin e një ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, si dhe për territorin e një ose më shumë komunave të qytetit të Beogradit.

(3) Trupat punuese nuk janë organe për zbatimin e zgjedhjeve, por vetëm i kryejnë detyrat e parashikuara me këtë Udhëzim.

(4) Trupat punuese kujdesen për organizimin e qendrave të votimit, organizojnë trajnimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të komisioneve të votimit për zhvillimin e votimit, e pranojnë materialin zgjedhor nga Koordinatorit, ia dorëzojnë materialin zgjedhor komisioneve të votimit para votimit, e marrin materialin zgjedhor nga komisionet e votimit pas votimit dhe ia dorëzojnë Koordinatorit.

## **Përbërja e trupit punues**

### **Neni 5.**

(1) Trupin punues e përbëjnë anëtarët e emëruar me propozim të kryeshefit të administratës komunale/të qytetit, përkatësisht të kryeshefit të administratës komunale/të qytetit, e ngarkuar për çështjet zgjedhore dhe kryeshefit të administratës komunale të qytetit të Beogradit (në tekstin e mëtejshëm: kryeshefi i administratës), nga radhët e personave të punësuar me arsimim të lartë në administratën komunale/të qytetit. Gjatë propozimit të kandidatëve për anëtarë të trupave punuese, përparësi duhet t'i jepet personave të regjistruar në listat e posaçme zgjedhore të pakicave kombëtare që kanë të mbaruar fakultetin e drejtësisë dhe përvojë në zhvillimin e zgjedhjeve.

(2) Nëse trupi punues formohet për zonën e një njësie të vetëqeverisjes vendore, e cila ka deri 10 qendra të votimit, trupi punues ka tre anëtarë.

(3) Nëse trupi punues formohet për zonën e një njësie të vetëqeverisjes vendore, e cila ka prej 10 deri në 20 qendra votimi, trupi punues i ka pesë anëtarë.

(4) Nëse trupi punues formohet për zonën e një njësie të vetëqeverisjes vendore, e cila ka mbi 20 qendra votimi, trupi punues ka shtatë anëtarë.

(5) Nëse trupi punues formohet për zonën e më shumë njësive të vetëqeverisjes vendore, ose më shumë se komuna të qytetit të Beogradit, trupi punues ka aq anëtarë sa ka njësi të vetëqeverisjes vendore, përkatësisht të komunave të qytetit që përfshin, të cilët emërohen me propozim të kryeshefit të administratës të secilës prej njësive të përfshira të vetëqeverisjes vendore.

(6) Në përbërjen e trupit punues bën pjesë edhe kryeshefi i administratës.

(7) Në qoftë se grupi punues formohet për zonën e më shumë njësive të vetëqeverisjes lokale, përkatësisht më shumë komuna të qytetit të Beogradit, në përbërjen e trupave punuese bëjnë pjesë kryeshefat e administratava të atyre njësive të vetëqeverisjes lokale, ose të komunave të qytetit.

(8) Nëse kryeshefi i administratës nuk është në gjendje t'i kryejë detyrat e anëtarit të trupit punues, në trupin punues hyn zëvendësi i tij. Nëse as zëvendëskryeshefi i administratës nuk është në gjendje t'i kryejë detyrat e anëtarit të trupit punues, kryeshefi i administratës në përbërjen e trupit punues do ta propozojë personin e punësuar në administratën përkatëse komunale/të qytetit për kryerjen e detyrave të anëtarit të trupit punues.

(9) Kryeshefi i administratës siguron kushtet për punë të trupit punues dhe koordinon punën e tij.

(10) Punën e trupit punues të formuar për zonën e më shumë njësive të vetëqeverisjes vendore, e koordinon kryeshefi i administratës së njësisë të vetëqeverisjes vendore, në të cilën gjendet selia e qarkut administrativ.

(11) Punën e trupit punues të formuar për territorin e më shumë komunave të qytetit të Beogradit, e koordinon kryeshefi i administratës të komunës së qytetit me numrin më të madh të votuesve, të regjistruar në listat e posaçme zgjedhore të pakicave kombëtare.

#### Neni 6.

Komisija me vendimi të posaçëm përcakton numrin, përbërjen dhe sferën e punës së trupave punuese, të paktën 30 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.

#### Neni 7.

(1) Propozimet për emërimin e anëtarëve të trupave punuese, kryeshefat e administratave ia paraqesin Komisionit brenda pesë ditëve, nga dita e miratimit të vendimit nga neni 6 i këtij udhëzimi.

(2) Propozimi për emërimin duhet të përfshijë: emrin dhe mbiemrin, profesionin, vendbanimin dhe adresën e banesës, numrin e telefonit celular dhe adresën për pranimin e postës elektronike.

(3) Koordinatori ka autoritetin të propozojë ndryshimin e propozimit të kryeshefit të administratës për emërimin e anëtarit të trupit punues, me ç'rast është i detyruar ta arsyetojë propozimin e tillë.

(4) Në qoftë se kryeshefi i administratës nuk propozon me kohë ndonjë anëtar të trupit punues, Komisioni do të emërojë për anëtar personin e përshtatshëm për kryerjen e kësaj detyre.

(5) Komisioni formon trupat punuese më së voni 20 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

### **Përbërja e komisionit zgjedhor**

#### Neni 8.

(1) Komisioni zgjedhor përbëhet nga kryetari, katër anëtarë dhe zëvendësit e tyre, të emëruar me propozim të kryeshefit të administratës.

(2) Për kryetar të komisionit zgjedhor dhe nënkryetar të komisionit zgjedhor, emërohen personat e punësuar në sektorin publik (organet shtetërore, organet e autonomisë territoriale dhe të vetëqeverisjes lokale, ndërmarrjet publike).

(3) Me rastin e propozimit të kryetarit, nënkryetarit, anëtarëve dhe zëvendësve të anëtarëve të komisionit zgjedhor, përparësi duhet t'i jepet personave të regjistruar në listat e posaçme zgjedhore të pakicave kombëtare.

(4) Me rastin e propozimit të kryetarit të komisionit zgjedhor, përparësi duhet t'i jepet personit që ka arsimim të lartë dhe përvojë në zhvillimin e zgjedhjeve.

#### Neni 9.

(1) Kryetarët, nënkryetarët, anëtarët dhe zëvendësit e anëtarëve të komisionit zgjedhor, i emëron Komisioni.

(2) Vendimin për formimin e komisioneve zgjedhore dhe emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të komisioneve zgjedhore dhe zëvendësve të tyre, Komisioni e miraton më së voni dhjetë ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.

(3) Trupi punues është i obliguar që më së voni dy ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve, për kryetarët dhe zëvendëskryetarët e komisioneve zgjedhore të organizojë trajnim për mbajtjen e votimit në qendrën e votimit dhe zbatimin e rregullave mbi punën e komisionit zgjedhor. Në qoftë se në vendin e votimit në të njëjtën kohë realizohen zgjedhjet për anëtarë të më shumë Këshillave Kombëtare, grupi i punës në trajnim, kësaj rrethane, do t'i kushtojë vëmendje të veçantë. Trupi punues është i obliguar që për trajnimin e kryer t'i japë raport me shkrim Komisionit, i cili duhet të përmbajë informacione në lidhje me kohën dhe vendin e mbajtjes së trajnimit, emrat e pranishëm të kryetarëve dhe zëvendëskryetarëve të komisioneve zgjedhore, një raport të shkurtër të rrjedhës së trajnimit dhe çështjet që janë trajtuar në mënyrë specifike ose ndoshta janë vlerësuar si kontestuese.

#### Neni 10.

(1) Propozimin për emërimin e kryetarit, zëvendëskryetarit, anëtarëve dhe zëvendësve të anëtarëve të komisioneve zgjedhore, kryeshefat e administratës ia paraqesin Komisionit më së voni 15 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

(2) Në propozimin për emërim ceken këto të dhëna në lidhje me individët e propozuar: emri dhe mbiemri, emri i prindit, numri personal identifikues i qytetarëve (në tekstin e mëtejme: NPIQ), vendbanimi dhe adresa e shtëpisë dhe numri i telefonit.

(3) Koordinatori është i autorizuar të propozojë ndryshimin e propozimit të kryeshefit të administratës për emërimin e anëtarëve të komisionit zgjedhor, me ç'rast është i detyruar ta arsyetojë propozimin e tillë.

(4) Në qoftë se kryeshefi i administratës nuk e propozon me kohë ndonjë person në komisionin zgjedhor, Komisioni në komisionin zgjedhor do të emërojë personin e duhur për të kryer detyrat në komisionin zgjedhor.

### **Kufizimet ligjore**

#### Neni 11.

(1) Një person mund të jetë anëtar vetëm i një komisioni zgjedhor.

(2) Me rastin e propozimit për emërimin dhe zëvendësimin e anëtarëve të komisionit zgjedhor, kryeshefi i administratës është i obliguar të kujdeset edhe për kufizimet ligjore në lidhje me anëtarësimin në komisionin zgjedhor.

### **Zëvendësimi i anëtarit të komisionit zgjedhor**

#### Neni 12.

(1) Zëvendësimin e anëtarit të komisionit zgjedhor, e bën Komisioni me propozimin e kryeshefit të administratës, më së voni pesë ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.

## **III. PARAQITJA E LISTËS ZGJEDHORE**

### **Kush mund ta paraqesë listën zgjedhore**

### Neni 13.

(1) Listën zgjedhore të kandidatëve për anëtarë të Këshillit Kombëtar (në tekstin e mëtejshëm: lista zgjedhore) mund ta paraqesë: grupi i votuesve të regjistruar në listën e veçantë zgjedhore, shoqata, objektivat e së cilës realizohen në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare dhe partia e regjistruar politike e pakicës kombëtare (në tekstin e mëtejshëm: propozuesi i listës zgjedhore).

(2) Grupin e votuesve e formojnë të paktën tre votues të regjistruar në listën e posaçme zgjedhore të pakicës kombëtare, Këshilli Kombëtar i së cilës zgjidhet.

(3) Grupi i votuesve formohet me marrëveshje me shkrim, të certifikuar në përputhje me ligjin me të cilin rregullohet vërtetimi i nënshkrimeve. Marrëveshja për formimin e grupit të votuesve patjetër përmban qëllimet e formimit të grupeve të votuesve, të dhënat mbi personat të cilët e kanë formuar (emrin dhe mbiemrin, NPIQ, vendin e banimit dhe adresën e banimit, të paraqitura sipas të dhënave nga letërnjoftimi) dhe personi që është caktuar për të përfaqësuar grupin e votuesve.

(4) Marrëveshja për formimin e grupit të votuesve, hartohet në gjuhën serbe, në shkrimin cirilik, por mund të hartohet edhe në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare, në mënyrë që çdo nen i marrëveshjes së pari do të përfshinte tekstin në gjuhën serbe dhe alfabetin cirilik, kurse poshtë tij teksti i paraqitur në gjuhën dhe alfabetin e pakicës kombëtare.

(5) Listën zgjedhore në emër të zgjedhësve, e paraqet personi i caktuar për të përfaqësuar grupin e votuesve, ose personi i cili është i autorizuar në marrëveshje për formimin e grupit të votuesve.

(6) Listën zgjedhore në emër të shoqatës, e paraqet përfaqësuesi i shoqatës i regjistruar në Regjistrin e shoqatave, ose personi i cili e autorizon ai, në formularin që e përcakton Komisioni.

(7) Listën zgjedhore në emër të partisë politike të pakicës kombëtare, e paraqet përfaqësuesi i partisë politike të regjistruar në Regjistrin e partive politike, ose personi i cili e autorizon ai, në formularin që e përcakton Komisioni.

(8) Personi i cili është i autorizuar për të paraqitur listën zgjedhore, është i autorizuar që edhe në emër të paraqitësve të listës zgjedhore të kryejë të gjitha veprimet e tjera në zgjedhje, përveç nëse propozuesi i listës zgjedhore nuk e përcakton ndryshe.

### **Afati për paraqitjen e listës zgjedhore**

### Neni 14.

Listat zgjedhore i paraqiten Komisionit në ndërtesën e Kuvendin Popullor në Beograd, Rruga e mbretit Milan 14, më së voni 15 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

### **Përmbajtja e listës zgjedhore**

### Neni 15.

(1) Lista zgjedhore paraqitet në formularin, të cilin e përcakton Komisioni, në formë të shkruar dhe elektronike (CD ose DVD).

(2) Përmbajtja e listës zgjedhore në formë të shkruar dhe listës zgjedhore në formë elektronike, duhet të jetë identike.

(3) Lista zgjedhore përmban:

- 1) emrin e propozuesit të listës zgjedhore,
  - 2) emrin e listës zgjedhore, e cila mund të përmbajë edhe emrin, edhe mbiemrin e ndonjë personi (bartësi i listës zgjedhore),
  - 3) të dhënat mbi të gjithë kandidatët për anëtarë të Këshillit Kombëtar (numrin rendor në listën zgjedhore, emrin dhe mbiemrin, NPIQ, profesionin, vendbanimin dhe adresën e banesës së kandidatit),
  - 4) emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e personit, i cili e paraqet listën zgjedhore.
- (4) Në listën zgjedhore duhet të jenë së paku një e treta e kandidatëve nga numri i anëtarëve të Këshillit Kombëtar i cili zgjidhet, e më së shumti aq kandidatë sa anëtarë të Këshillit Kombëtar zgjidhen.
- (5) Kandidat mund të jetë vetëm ai person, i cili është i regjistruar në listën e posaçme zgjedhore të pakicës kombëtare, Këshilli Kombëtar i së cilës zgjidhet.
- (6) Emri dhe mbiemri i kandidatit paraqiten në listën e kandidatëve sipas drejtshkrimit serb dhe alfabetit cirilik, kurse mund të paraqiten edhe sipas drejtshkrimit dhe alfabetit të pakicës kombëtare, me ç'rast renditjen e përcakton propozuesi.
- (7) Në listën zgjedhore në mes çdo tre kandidatëve sipas radhitjes në listën zgjedhore (tri vendet e para, tri vendet e dyta, e kështu me radhë deri në fund të listës), duhet të jetë të paktën nga një kandidat – pjesëtar i asaj gjinie, i cili më pak përfaqësohet në listë.
- (8) Nëse lista zgjedhore nuk i plotëson kushtet përmbajtësore nga ky nen, konsiderohet se përmban mangësi për shpallje.

### **Emri i propozuesit të listës zgjedhore**

Neni 16.

- (1) Nëse listën zgjedhore e paraqet grupi i votuesve, emri i propozuesit duhet në fillim të përmbajë emrin „Grupi i votuesve”. Nëse grupi i votuesve ka emër, është i obliguar që në listën zgjedhore si emër i propozuesit, pas shenjës „Grupi i votuesve” ta paraqesë emrin e vet nga marrëveshja për formimin e grupit të votuesve. Emri i grupit të votuesve nuk mund të përmbajë fjalët "partia" ose "shoqata", në asnjë rasë, as emrin e partisë së regjistruar politike apo shoqate të regjistruar.
- (2) Nëse listën zgjedhore e paraqet shoqata, është e obliguar që në listën zgjedhore emrin e vet si propozues i listës zgjedhore, ta paraqesë sipas emrit nga akti për regjistrim të shoqatës.
- (3) Nëse listën zgjedhore e paraqet partia politike e pakicës kombëtare, është e obliguar që në listën zgjedhore, ta paraqesë emrin e vet si propozuese e listës zgjedhore sipas emrit nga akti i regjistrimit të partisë politike.

### **Emri i listës zgjedhore**

Neni 17.

- (1) Lista zgjedhore e ka emrin të cilin e cakton propozuesi i listës zgjedhore.

(2) Nëse listën zgjedhor e propozon grupi i votuesve, emri i listës zgjedhore përmban emrin e përcaktuar me marrëveshjen mbi formimin e grupeve të votuesve. Në emrin e listës zgjedhore mund të përfshihet emri dhe mbiemri i personave, të cilët grupi i votuesve i cakton si bartës të listës zgjedhore. Emri i listës zgjedhore të grupit të votuesve nuk mund të përmbajë fjalët „shoqatë” dhe „parti” në asnjë rasë, as emrin e shoqatës së regjistruar ose të partisë politike të regjistruar.

(3) Nëse listën zgjedhore e propozon shoqata, emri i listës zgjedhore mund të përmbajë emrin e shoqatës, e cila paraqitet sipas emrit të shoqatës nga akti i regjistrimit të saj. Në emër të listave zgjedhore mund të përfshihet edhe emri, edhe mbiemri i personave të cilët shoqata i cakton si bartës të listës zgjedhore.

(4) Nëse listën zgjedhore e paraqet partia politike e pakicës kombëtare, emri i listës zgjedhore duhet të përmbajë emrin e partisë politike nga akti i regjistrimit të saj. Në emër të listës zgjedhore mund të përfshihet edhe emri, edhe mbiemri i personave, të cilat partia politike e pakicës kombëtare i cakton si bartës të listës zgjedhore.

(5) Emrin e listës zgjedhore që e propozon grupi i votuesve ose i shoqatës, nuk mund t'i referohet emrit të kishës dhe bashkësisë fetare.

(6) Emri i listës zgjedhore paraqitet në gjuhën serbe dhe me alfabet cirilik, ndërsa mund të jepet edhe në gjuhën dhe alfabetin e pakicës kombëtare.

### **Dokumentacioni që dorëzohet me listën zgjedhore**

#### **Neni 18.**

(1) Listës zgjedhore i bashkangjitet dokumentacioni në vijim:

1) deklarata e secilit kandidat se e pranon kandidaturën për anëtar të Këshillit Kombëtar, të certifikuar në përputhje me ligjin që rregullon vërtetimin e nënshkrimeve, në formularin që e përcakton Komisioni;

2) pëlqimin e bartësit të listës (nëse është caktuar) të jetë bartës i listës zgjedhore, në formularin të cilin e përcakton Komisioni;

3) autorizimin e personit, të cilin propozuesi e ka autorizuar ta paraqesë listën zgjedhore, në formularin të cilin e përcakton Komisioni, nëse listën zgjedhore e paraqet shoqata apo partia politike e pakicës kombëtare;

4) deklaratat e votuesve se e mbështesin listën zgjedhore, të certifikuara në përputhje me ligjin që rregullon vërtetimin e nënshkrimeve dhe të radhitura sipas rendit alfabetik të mbiemrave të votuesve, në formularin të cilin e përcakton Komisioni;

5) listën e zgjedhësve që e mbështesin listën zgjedhore, të radhitur sipas rendit alfabetik të mbiemrave të votuesve, të punuar në formë të shkruar dhe elektronike (CD ose DVD), në mënyrë që lista në të dy format të jetë identike, e të cilën e nënshkruan personi që e paraqet listën zgjedhore, në formularin që e përcakton Komisioni. Lista në formë elektronike duhet të jetë e punuar në programin Excel, në tabelën e publikuar në faqen e internetit të Komisionit: [www.rik.parlament.gov.rs](http://www.rik.parlament.gov.rs);

6) marrëveshjen e certifikuar për formimin e grupit të votuesve, nëse listën zgjedhore e propozon grupi i votuesve;

7) kopjen e vërtetuar e statutit të shoqatës, nëse listën zgjedhore e propozon shoqata.



(2) Listën zgjedhore me nënshkrimet e tyre duhet ta mbështetë të paktën 1%, e jo më pak se 50 votues të regjistruar në listën e veçantë të votuesve të pakicës kombëtare, Këshilli Kombëtar i së cilës zgjidhet.

(3) Për të përcaktuar numrin më të vogël të nënshkrimeve të zgjedhësve, të nevojshëm për mbështetjen e listës zgjedhore, kompetent është vendimi i ministritë përgjegjëse për menaxhimin e listës së veçantë të votuesve mbi përmbylljen e përkohshme të listës së posaçme zgjedhore.

(4) Votuesi me nënshkrimin e vet mund ta përkrahë listën zgjedhore vetëm të një propozuesi.

(5) Formularët për dorëzimin e listës zgjedhore, i përcakton Komisioni me akt të veçantë dhe i publikon ato brenda pesë ditëve, nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve.

### **Mangësitë e listës zgjedhore**

#### **Neni 19.**

(1) Kur Komisioni konstaton se lista zgjedhore nuk është paraqitur me kohë, do të marrë vendim për refuzimin e listës zgjedhore.

(2) Kur Komisioni konstaton se lista zgjedhore përmban mangësi, të cilat pamundësojnë shpalljen e listës zgjedhore, brenda 24 orëve, nga marrja e listës zgjedhore, sjell konkluzionin me të cilin propozuesi i listës urdhërohet që, më së voni brenda 48 orëve, nga momenti i dorëzimit të konkluzionit, t'i eliminojë ato mangësi. Në konkluzion, propozuesit të listës zgjedhore i tregohet mënyra për eliminimin e mangësive.

(3) Kur Komisioni konstaton se lista zgjedhore ka mangësi, përkatësisht nëse konstaton se mangësitë nuk janë eliminuar, apo nuk janë eliminuar brenda afatit të caktuar, në 48 orët e ardhshme do të nxjerrë vendimin për refuzimin e shpalljes së listës zgjedhore.

### **Shpallja e listës zgjedhore**

#### **Neni 20.**

(1) Komisioni e shpall listën zgjedhore të propozuesit menjëherë pas pranimit të listës zgjedhore dhe dokumentacionit përcjellës, e më së voni brenda 24 orëve, nga marrja e listës zgjedhore.

(2) Vendimin për shpalljen e listës zgjedhore nga paragrafi 1 i këtij neni, Komisioni, pa vonesë, ia dorëzon propozuesit.

(3) Propozuesi i listës zgjedhore mund ta tërheqë listën zgjedhore më së voni deri në ditën e konfirmimit të listës së përgjithshme zgjedhore.

#### **Neni 21.**

(1) Në rast se për zgjedhjet për anëtarë të Këshillit të caktuar Kombëtar nuk paraqitet asnjë listë zgjedhore, respektivisht asnjë listë e paraqitur zgjedhore nuk shpallet, Komisioni sjell vendim për ndërprerjen e procedurës të zgjedhjes së anëtarëve të atij Këshilli Kombëtar.

(2) Kur vendimi për ndërprerjen e procedurës së zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar, bëhet i plotfuqishëm, Komisioni për këtë e lajmëron Ministrinë përgjegjëse për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave.

#### IV. LISTA E PËRMBLEDHËSE ZGJEDHORE

##### Neni 22.

(1) Lista përmbledhëse zgjedhore për zgjedhjen e secilit këshill kombëtar në veçanti, përmban të gjitha listat zgjedhore, me emrat personalë të të gjithë kandidatëve dhe informacionet mbi vitin e lindjes, profesionin dhe vendin e banimit.

(2) Renditja e listave zgjedhore në listën përmbledhëse zgjedhore, përcaktohet sipas rendit të shpalljes së tyre.

(3) Komisioni përcakton listat përmbledhëse zgjedhore të kandidatëve për anëtarë të secilit Këshill Kombëtar në veçanti, dhe i publikon në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë”, më së voni 10 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

##### Neni 23.

(1) Komisioni nuk do ta përcaktojë listën përmbledhëse zgjedhore, nëse numri i kandidatëve në listat e shpallura zgjedhore, është më i vogël se numri i anëtarëve të Këshillit Kombëtar i cili zgjidhet.

(2) Në rastin e paragrafit 1 të këtij neni, Komisioni mer vendim për pezullimin e procedurës për zgjedhjen e anëtarëve të atij Këshilli Kombëtar.

(3) Kur vendimi për pezullimin e procedurës së zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar merr formë të prerë, Komisioni për këtë e njofton Ministrinë përgjegjëse për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave.

#### V. QENDRAT E VOTIMIT

##### **Kompetenca për përcaktimin e vendeve të votimit**

##### Neni 24.

(1) Komisioni përcakton dhe shpall në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë”, qendrat e votimit, në të cilat do të votohet në zgjedhje, më së voni 20 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

(2) Komisioni përcakton qendrat e votimit në bashkëpunim me administratat komunale/të qytetit, respektivisht me administratat komunale të qytetit të Beogradit (në tekstin e mëtejme: administrata komunale/e qytetit).

(3) Vendvotimet brenda institucioneve të burgut, përcaktohen në përputhje me të dhënat e marra të ministrisë përgjegjëse për çështjet e drejtësisë, mbi numrin e zgjedhësve që në ditën e zgjedhjeve do të jenë në paraburgim ose në vuajtje të dënimit me burg, të cilat i paraqiten Komisionit më së voni 25 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

(4) Komisioni, në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për mbrojtje dhe administrata komunale/të qytetit, e përcakton në cilat vendvotime tashmë të përcaktuara, do të votojnë votuesit, të cilët në ditën e zgjedhjeve do të jenë në shërbimin ushtarak, stërvitje ushtarake ose në shkollim në institucionet ose njësitë e Ushtrisë së Serbisë.

## **Mënyra e caktimit të vendeve të votimit**

Neni 25.

- (1) Vendi i votimit caktohet për votim për të paktën 100, e më së shumti 2.500 votues.
- (2) Në raste të veçanta, mund të caktohet vendi i votimit edhe për votim të më pak se 100 votuesve, në qoftë se, për shkak të distancës hapësinore apo pozitës së pafavorshme gjeografike, votimi për votuesit në qendrën tjetër të votimit do të ishte shumë më i vështirë.
- (3) Vendvotimi mund të përfshijë territorin e një apo më shumë njësisive të vetëqeverisjes vendore, pjesë e vendbanimit, e një vendbanimi ose e disa vendbanimeve.
- (4) Për çdo vendvotim përcaktohet: numri i qendrës së votimit, emri i qendrës së votimit, adresa e qendrës së votimit dhe zona nga e cila votuesit votojnë në atë qendër votimi.
- (5) Për qendrat e votimit, sipas rregullës, caktohen objektet në pronësi publike, dhe vetëm në raste të jashtëzakonshme edhe objektet në pronësi private.
- (6) Qendra e votimit nuk mund të jetë në objektin në pronësi të partisë politike apo të cilin e shfrytëzon partia politike, si dhe në objektin në pronësi të kandidatit për anëtar të Këshillit Kombëtar, ose anëtarit të familjes së tij.
- (7) Gjatë përcaktimit të qendrës së votimit, do të merret parasysh që vendi i votimit të jetë i arritshëm për personat me aftësi të kufizuara.

## **Organizimi i qendrave të votimit**

Neni 26.

- (1) Trupi punues është i obliguar që në bashkëpunim me administratën komunale/të qytetit, me kohë të sigurojë që hapësira, e cila është përcaktuar si vend i votimit, të jetë e përgatitur dhe e hapur për votim.
- (2) Hapësira për votim duhet të jetë e rregulluar në atë mënyrë që mundëson zhvillimin e papengueshëm të votimit.
- (3) Në vendin e votimit dukshëm të shënohet numri dhe emri i qendrës së votimit, flamuri kombëtar i Republikës së Serbisë, listën përmbledhëse zgjedhore të kandidatëve për anëtarë të Këshillit Kombëtar dhe ekstraktet nga vendimet për caktimin e qendrave të votimit.
- (4) Në qendrën e votimit dhe 50 metra nga qendra e votimit, ndalohet vënia e simboleve të propozuesve të listave zgjedhore dhe materialit tjetër propagandistik zgjedhor.
- (5) Komisioni zgjedhor do t'iu sigurojë individëve, të cilët mbikqyrin, apo përcjellin punën e komisionit zgjedhor (përfaqësuesve të propozuesve të listave të shpallura zgjedhore dhe vëzhguesve) vendin e duhur prej ku mund të monitorojnë procesin e votimit dhe vërtetimin e rezultateve të votimit.

## **VI. LISTAT E POSAÇME ZGJEDHORE**

### **Regjistrimi dhe ndryshimet në listën e posaçme të votuesve**

## Neni 27.

(1) Administrata komunale/e qytetit, e cila është përgjegjëse për përditësimin e pjesës së listës së posaçme zgjedhore, të pakicës së caktuar kombëtare, bën regjistrimin e zgjedhësve që nuk janë të regjistruar në listën e posaçme të votuesve, si dhe ndryshimin e të dhënave në listën e posaçme të votuesve, deri në përmbylljen e saj, përkatësisht më së voni 15 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

(2) Që nga përmbyllja e listës së posaçme zgjedhore të pakicave kombëtare (në tekstin e mëtejshëm: lista zgjedhore), e deri në 72 orë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve, regjistrimin e votuesve të cilët nuk janë të regjistruar në listën zgjedhore dhe ndryshimet në listën zgjedhore, i bën ministria përgjegjëse për menaxhimin e listës zgjedhore.

### **Përmbyllja e listës zgjedhore dhe publikimi i numrit të përgjithshëm të votuesve**

## Neni 28.

(1) Ministria përgjegjëse për menaxhimin e listës zgjedhore, me vendim e përmbyll listën e zgjedhësve, 15 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve dhe në vendim e përcakton numrin e përgjithshëm të votuesve për çdo pakicë kombëtare, si dhe numrin e votuesve sipas vendeve të votimit, edhe atë gjithsej për çdo vendvotim dhe të radhitura sipas pakicave kombëtare.

(2) Në numrin e përgjithshëm të votuesve nuk përfshihet numri i votuesve, të cilët janë të regjistruar në ekstrakte të veçanta të listës zgjedhore për votim të votuesve, të cilët në ditën e zgjedhjeve do të gjenden në shërbimin ushtarak, stërvitje ushtarake, ose në shkollim në njësitet ose institucionet e Ushtrisë së Serbisë, përkatësisht të votuesve të cilët në ditën e zgjedhjeve do të jenë në paraburgim ose në vuajtje të dënimit me burg.

(3) Vendimin për përmbylljen e listës zgjedhore, ministria përgjegjëse për menaxhimin e listës zgjedhore, e publikon në «Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë» brenda 24 orëve nga miratimi i tij dhe ia dorëzon Komisionit.

### **Dorëzimi i ekstrakteve nga lista zgjedhore**

## Neni 29.

Ministria përgjegjëse për menaxhimin e listës zgjedhore, i përpilon ekstraktet e vërtetuara nga lista zgjedhor dhe ekstraktet e veçanta për çdo vendvotim dhe çdo pakicë kombëtare, dhe ia dorëzon ato Komisionit brenda 48 orëve, nga përmbyllja e listës zgjedhore.

### **Dorëzimi i vendimeve mbi ndryshimet plotësuese në listat zgjedhore**

## Neni 30.

(1) Ministria përgjegjëse për menaxhimin e listës zgjedhore, ia dorëzon Komisionit të gjitha vendimet për ndryshimet mbi të cilat mbështeten ndryshimet në listën zgjedhore, të cilin e ka miratuar pas përmbylljes së listës zgjedhore, deri në 72 orë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

(2) Në rast se me vendimin për ndryshimin e të dhënave në listën zgjedhore, ndërrohet vendi i votimit në të cilin zgjedhësi voton, ai vendim duhet të përmbajë shenjën e vendvotimit, nga i cili zgjedhësi fshihet dhe shenjën e qendrës së votimit në të cilën zgjedhësi regjistrohet.

## **Regjistrimi i të dhënave nga vendimet mbi ndryshimet plotësuese në listën zgjedhore**

### **Neni 31.**

(1) Komisioni, në bazë të vendimeve të ministrisë përgjegjëse për menaxhimin e listës zgjedhore nga neni 30 i këtij Udhëzimi, regjistron ndryshimet në ekstraktet e listës zgjedhore dhe ekstraktet e veçanta nga lista zgjedhore, duke i marrë parasysh vetëm ato vendime që i ka pranuar të paktën 48 orë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

(2) Regjistrimi i ndryshimeve në ekstraktin nga lista zgjedhore dhe ekstraktit të veçantë nga lista e posaçme zgjedhore, bëhet sipas të dhënave nga vendimet mbi të cilat janë të bazuara ndryshimet në listën zgjedhore, duke filluar nga numri rendor 1, në fund të ekstraktit të listës zgjedhore, në faqe të veçantë, me emrin: „Ndryshimet plotësuese”.

## **Përcaktimi dhe publikimi i numrit përfundimtar të votuesve**

### **Neni 32.**

Komisioni, menjëherë pas regjistrimit të ndryshimeve nga neni 30 i këtij Udhëzimi, përcakton dhe publikon në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë”, numrin përfundimtar të votuesve për çdo pakicë kombëtare, si dhe numrin e zgjedhësve nëpër qendra votimi, edhe atë numrin e përgjithshëm për çdo vendvotim dhe të klasifikuar sipas pakicave kombëtare.

## **VII. NJOFTIM RRETH DITËS DHE KOHËS SË MBAJTJES SË ZGJEDHJEVE**

### **Neni 33.**

(1) Dorëzimin e njoftimeve votuesve lidhur me ditën dhe kohën e mbajtjes së zgjedhjeve, me numrin dhe adresën e vendit të votimit ku zgjedhësi voton dhe numri me të cilin është regjistruar në ekstraktin e listës zgjedhore, e bën administrata komunale/e qytetit.

(2) Dorëzimi i njoftimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, bëhet jo më vonë se pesë ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.

## **VIII. DORËZIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR KOMISIONEVE ZGJEDHORE PARA VOTIMIT**

### **Sigurimi i materialit zgjedhor**

### **Neni 34.**

(1) Materialin zgjedhor për zhvillimin e zgjedhjeve e siguron Komisioni.

(2) Administratat komunale/të qytetit për çdo komisin zgjedhor me kohë e sigurojnë:

1) kutinë e votimit;

2) dy grupe paravan për të siguruar fshehtësinë e votimit;

3) dy spreja për të shënuar gishtat e votuesve;

- 4) dy llamba UV;
- 5) qesen për depozitimin e materialit zgjedhor;
- 6) pajisjet për shkrim;
- 7) Pajisjet për vulosjen e kutive të votimit dhe materialit tjetër zgjedhor (vulën dhe dyllin për nënshkrim);
- 8) zarfat për vendosjen e fletave të votimit.

(3) Administrata komunale/e qytetit dhe administratat e komunave të qytetit të Beogradit, janë të obliguara që me kohë të sigurojnë hapësirën për ruajtjen e sigurt të materialit zgjedhor dhe të kujdesen që hapësira, e cila është përcaktuar si vend i votimit, të jetë e rregulluar sipas mënyrës së përcaktuar me ligj dhe e hapur për votim.

### Neni 35.

Komisioni për çdo komision zgjedhor siguron këtë material zgjedhor:

- 1) Listat përmbledhëse zgjedhore të kandidatëve për anëtar të secilit Këshill Kombëtar, i cili zgjidhet në vendin e votimit;
- 2) vendimin për caktimin e vendeve të votimit (ekstraktin);
- 3) vendimin mbi formimin e komisionit zgjedhor;
- 4) ekstraktet nga lista zgjedhore për të votuar në vendin e votimit për çdo Këshillit Kombëtar, i cili zgjidhet në vendin e votimit, duke përfshirë edhe ekstraktet e posaçme për votim të votuesve në paraburgim ose në vuajtje të dënimit;
- 5) ekstrakte të veçanta nga lista zgjedhore për votim të votuesve në shërbimin ushtarak, stërvitje ushtarake ose në shkollim në institucionet ose njësitë e Ushtrisë së Serbisë;
- 6) numrin e nevojshëm të fletëve të votimit, i cili përputhet me numrin e zgjedhësve të regjistruar në ekstrakte nga pika 4 dhe 5 të këtij neni;
- 7) fletën kontrolluese për të verifikuar saktësinë e kutisë së votimit;
- 8) formularin e vërtetimit të së drejtës për të votuar jashtë vendit të votimit;
- 9) formularin e procesverbalit mbi punën e komisionit zgjedhor në zbatimin e votimit dhe vërtetimin e rezultateve të votimit në zgjedhjet për anëtar të secilit Këshill Kombëtar, i cili zgjidhet në qendrën e votimit (në tekstin e mëtejshëm: Procesverbal mbi punën e komisionit zgjedhor), në gjashtë kopje;
- 10) formularin e evidencës mbi praninë e anëtarëve dhe zëvendës anëtarëve të komisionit zgjedhor në qendrën e votimit;
- 11) listat e përfaqësuesve të propozuesve të listave zgjedhore për mbikëqyrjen e punës së komisioneve zgjedhore;
- 12) kompetencat e vëzhguesve për të monitoruar punën e komisioneve zgjedhore;

13) rregullat e punës të komisioneve zgjedhore;

14) flamurin kombëtar të Republikës së Serbisë.

### **Dorëzimi i materialit zgjedhor nëpërmjet trupit punues**

#### **Neni 36.**

(1) Materialin e shtypur zgjedhor, Koordinatorin e merr nga Ndërmarrja publike „Gazeta Zyrtare” më së voni 72 orë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

(2) Materialin zgjedhor nga neni 35 i këtij Udhëzimi, Koordinatorin ia dorëzon trupit punues në selinë e rrethit administrativ, kurse për qytetin e Beogradit në shtypshkronjën e Ndërmarrjes publike „Gazeta Zyrtare”.

(3) Dorëzimi nga paragrafi 2 i këtij neni, bëhet më së voni 72 orë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve. Rreth dorëzimit të kryer të materialit zgjedhor, përpilohet procesverbali në formularin, të cilin e përcakton Komisioni.

(4) Trupi punues, materialin e pranuar, së bashku me materialin që e ka siguruar administrata komunale/e qytetit, respektivisht administrata e komunave të qytetit të Beogradit (kutitë e votimit, paravanet për të siguruar fshehtësinë e votimit, pajisjet për shkrim, pajisjet për vulosjen e kutive të votimit dhe materialit tjetër zgjedhor, spreji, llambat UV dhe zarfat për vendosjen e fletave të votimit), ia dorëzon komisioneve zgjedhore, në selinë e komunës/qytetit, më së voni 48 orë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve. Rreth dorëzimit të kryer të materialit zgjedhor, përpilohet procesverbal në formularin që e përcakton Komisioni.

## **IX. DORËZIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR TE KOMISIONI PAS VOTIMIT**

### **Dorëzimi i materialit zgjedhor nëpërmjet trupit punues**

#### **Neni 37.**

(1) Pasi konstaton rezultatet e votimit në vendin e votimit, komisioni zgjedhor pa vonesë, në ndërtesën e komunës/qytetit, ia dorëzon trupit punues këtë material zgjedhor:

1) kopjet e para të procesverbalit mbi punën e komisionit zgjedhor në zbatimin e votimit dhe vërtetimin e rezultateve të votimit në zgjedhjet për anëtarë të secilit Këshill Kombëtar, të cilët janë zgjedhur në vendin e votimit,

2) ekstraktet nga lista zgjedhore dhe ekstraktet e veçanta nga lista zgjedhore, sipas të cilave është votuar në qendrën e votimit në zgjedhjet për anëtarë të secilit Këshill Kombëtar,

3) zarfi i mbyllur në të cilin gjendet fleta kontrolluese për të verifikuar saktësinë e kutisë së votimit,

4) zarfat e mbyllur në të cilët janë vendosur fletëvotimet e papërdorura për të votuar në zgjedhjet për anëtar të secilit Këshill Kombëtar, i cili është zgjedhur në qendrën e votimit në veçanti,

5) zarfat e mbyllur në të cilët janë vendosur fletëvotimet e pavlefshme për të votuar në zgjedhjet për anëtar të çdo Këshilli Kombëtar, i cili është zgjedhur në qendrën e votimit në veçanti,

6) zarfat e mbyllur në të cilët janë vendosur fletëvotimet e vlefshme për votim në zgjedhjet për anëtar të çdo Këshilli Kombëtar, i cili është në qendrën e votimi në veçanti,

7) zarfat e mbyllur në të cilët janë vendosur vërtetimet e nënshkruara për të drejtën zgjedhore jashtë qendrës së votimit në zgjedhjet për anëtarë të secilit Këshill Kombëtar në veçanti.

(2) Rreth dorëzimit nga paragrafi 1 i këtij neni, përpilohet procesverbali në formularin, i cili është përcaktuar nga Komisioni.

(3) Trupi punues, procesverbalet mbi punën e komisioneve të votimit, ekstrakteve nga lista zgjedhore dhe vërtetimet mbi të drejtën për të votuar jashtë qendrës së votimit, i paketën ndaras nga materiali tjetër zgjedhor.

(4) Pasi e merr materialin zgjedhor nga të gjitha komisionet e votimit, trupi punues atë material menjëherë ia dorëzon Koordinatorit në selinë e rrethit administrativ, për të cilin përpilohet procesverbali në formularin e përcaktuar nga Komisioni.

(5) Grupet punuese për qytetin e Beogradit, materialin e marrë nga të gjitha komisionet e votimit, ia dorëzojnë Koordinatorit në godinën e Kuvendit Popullor në Beograd, Rruga e mbretit Milan 14, për të cilin përpilohet procesverbali në formularin që e përcakton Komisioni.

## X. STANDARDET PËR MATERIALIN ZGJEDHOR

### Fletëvotimet

#### Neni 38.

(1) Numri i fletëve të votimit të cilat shtypen, duhet të jetë i barabartë me numrin e zgjedhësve, të regjistruar në listën zgjedhore për çdo pakicë kombëtare, Këshilli Kombëtar i së cilës zgjidhet.

(2) Komisioni me vendim, i cili publikohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë”, e përcakton numrin e fletëve të votimit që shtypen, si dhe numrin e fletëve rezervë të votimit.

(3) Numri i fletëvotimeve rezervë për secilin Këshill Kombëtar i cili zgjidhet, nuk mund të jetë më i madh se 0.5% nga numri i përgjithshëm i votuesve të çdo pakice kombëtare, as më pak se 10.

(4) Komisioni e përcakton tekstin, formën dhe pamjen e fletëve të votimit.

### Përdorimi i gjuhës dhe shkrimeve

#### Neni 39.

(1) Teksti i formularit për dorëzimin e listës zgjedhore, teksti përmbledhës i listës zgjedhore, teksti i fletës së votimit, teksti i formularit të procesverbalit mbi punën e komisioneve zgjedhore dhe teksti i vërtetimeve për zgjedhjen si anëtarë të Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare, shtypen në gjuhën serbe, me alfabet cirilik.

(2) Në qoftë se gjuha dhe shkrimi i pakicës kombëtare, Këshilli i të cilës zgjidhet, janë në përdorim zyrtar të paktën në një njësi të vetëqeverisjes vendore, tekstet e materialeve nga paragrafi 1 i këtij neni, shtypen në dy gjuhë, respektivisht në gjuhën dhe alfabetin e pakicës kombëtare, në atë mënyrë që teksti në gjuhën dhe shkrimin e pakicave kombëtare, shtypet nën tekstin në gjuhën serbe dhe alfabetit cirilik, në të njëjtën formë dhe me të njëjtën madhësi të shkronjave.



## **Përgatitja për shtypjen e fletëve të votimit**

### Neni 40.

(1) Pas marrjes së vendimit mbi tekstin dhe pamjen e fletëve të votimit, Komisioni harton një mostër të fletëvotimit, të cilën e vërteton kryetari i Komisionit me nënshkrimin e vet dhe vulën e Komisionit.

(2) Në bazë të mostrës së vërtetuar të fletëvotimit, shtypshkronja i prodhon tabelat grafike.

(3) Procesi i shtypjes fillon duke i vendosur tabelat grafike në makinat për shtypje, në praninë e përfaqësuesve të Komisionit.

(4) Me vënien në funksion të makinave të shtypit, kopjet e para të fletëve të votimit shkatërrohen aty për aty, deri në momentin kur të shtypet fletëvotimi që i plotëson standardet optimale grafike.

(5) Fletëvotimin e parë të shtypur, i cili i plotëson standardet optimale grafike, kryetari i Komisionit e krahason me mostrën e vërtetuar të fletëvotimit.

(6) Pasi konstaton se kopja e shtypur e fletëvotimit, përputhet me mostrën e vërtetuar, kryetari i Komisionit me nënshkrimin e vet e aprovon shtypjen e fletëve të votimit në numin e caktuar të kopjeve.

(7) Menjëherë pas përfundimit të shtypjes, komisioni i përbërë nga përfaqësues të Komisionit, propozuesve të listave zgjedhore dhe shtypshkronjës, e shkatërron përgatitjen kompjuterike për prodhimin e pllakave grafike.

(8) Rreth shkatërrimit të përgatitjes kompjuterike dhe pllakave grafike, përpilohet procesverbal, ndërsa pllakat e shkatërruara grafike i dorëzohen Komisionit.

## **Mbikqyrja e të shtypurit**

### Neni 41.

(1) Shtypjen e fletëve të votimit e mbikëqyr Komisioni.

(2) Komisioni është i obliguar të sigurojë shtypjen publike të fletëvotimeve.

(3) Përfaqësuesit e propozuesve të listave zgjedhore, kanë të drejtë të marrin pjesë në shtypjen, numërimin dhe paketimin e fletëve të votimit dhe dorëzimin e fletëve të votimit Komisionit, trupave punuese, përkatësisht komisioneve zgjedhore.

(4) Komisioni është i obliguar t'i njoftojë me kohë propozuesit e listave zgjedhore rreth asaj se përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë të marrin pjesë në shtypjen, numërimin, paketimin dhe dorëzimin e fletëve të votimit, si dhe ku zhvillohen dhe kur fillojnë ato aktivitete.

## **Kutia e votimit**

### Neni 42.

Për votim në zgjedhje, përdoret kutia e votimit e punuar në përputhje me udhëzimet për formën dhe dimensionet e kutisë së votimit („Gazeta Zyrtare e RS”, nr. 42/00).

### **Spreji për shënimin e gishtave të votuesve**

Neni 43.

Shënimi i gishtave të votuesve si shenjë se votuesi ka votuar, bëhet me yndyrë speciale të pazbërthyeshme UV, që është e dukshme nën dritën e veçantë të llambës UV.

## **XI. PËRPUNIMI STATISTIK I TË DHËNAVE**

Neni 44.

(1) Analizën statistikore të të dhënave gjatë zhvillimit të zgjedhjeve, e bën organizata kompetente republikane, në bazë të procesverbalit mbi punën e komisioneve zgjedhore, të cilat ia dorëzon Komisioni.

(2) Organizata republikane përgjegjëse për çështjet statistikore, e cakton personin i cili pas përfundimit të votimit, do të marrë pjesë në pranindorëzimin e materialit zgjedhor në mes të komisioneve zgjedhore dhe trupave punuese, dhe do të bëjnë kontrollin logjik dhe kompjuterik të të dhënave në procesverbalet mbi punën e komisioneve zgjedhore, si dhe do të përgatisin të dhënat për rezultatet e përkohshme të zgjedhjeve.

## **XII. MBIKQYRJA DHE MONITORIMI I PUNËS SË ORGANEVE DHE TRUPAVE PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE**

### **Përfaqësuesit e propozuesve të listave të shpallura zgjedhore**

Neni 45.

(1) Punën e organeve për zbatimin e zgjedhjeve, mund ta mbikëqyrin përfaqësuesit e propozuesve të listave të shpallura zgjedhore.

(2) Për mbikëqyrjen e punës së Komisionit, propozuesi i listës së shpallur zgjedhore mund të autorizojë deri në dy përfaqësues të tij, me kusht që në mbledhjen e Komisionit mund të marrë pjesë vetëm një përfaqësues i propozuesve të listës së shpallur zgjedhore.

(3) Për mbikëqyrjen e punës së komisionit zgjedhor në zbatimin e votimit dhe vërtetimit të rezultateve të votimit, propozuesi i listës së shpallur zgjedhore, mund të autorizojë deri në dy përfaqësues të tij, me kusht që në vendin e votimit mund të jetë i pranishëm vetëm një përfaqësues i propozuesve të listës së shpallur zgjedhore.

(4) Një përfaqësues i propozuesve të listës së shpallur zgjedhore, mund të autorizohet për mbikëqyrjen e punës së më shumë komisioneve të votimit, me kusht që për mbikëqyrjen e punës të një komisioni zgjedhor, mund të caktohen vetëm dy persona.

(5) Për mbikëqyrjen e punës së organeve për zhvillimin e zgjedhjeve, propozuesi i listës zgjedhore mund të autorizojë qytetarin e moshës madhore të Republikës së Serbisë.

(6) Për mbikëqyrjen e punës së organeve për zhvillimin e zgjedhjeve, propozuesi i listës zgjedhore nuk mund të autorizojë kandidatin për anëtar të Këshillit Kombëtar, ose anëtarin e organit dhe trupit të angazhuar në zhvillimin e zgjedhjeve.

(7) Përfaqësuesit e propozuesve të listës zgjedhore, mund të mbikëqyrin punën vetëm e atyre komisioneve të votimit, të cilët i zhvillojnë zgjedhjet për anëtarë të Këshillit Kombëtar në të cilën merr pjesë propozuesi i listës së shpallur zgjedhore.

(8) Për përfaqësuesit e vet, të autorizuar për mbikëqyrjen e punës së Komisionit, propozuesi i listës së shpallur zgjedhore, e informon Komisionin më së voni pesë ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

(9) Për përfaqësuesit e vet, të autorizuar për mbikëqyrjen e punës së komisioneve zgjedhore, sipas njësive të vetëqeverisjes lokale dhe qendrave të votimit, propozuesi i listës së shpallur zgjedhore, e informon Komisionin më së voni dhjetë ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve, në formularin që e përcakton Komisioni.

(10) Njoftimet e pranuar me kohë nga paragrafi 9 i këtij neni, Komisioni ia dorëzon komisioneve zgjedhore, nëpërmjet trupave punuese.

(11) Personi i cili gjendet në listën e përfaqësuesve të autorizuar të propozuesve të listës zgjedhore, të paraqitur tek komisioni zgjedhor nga ana e Komisionit, dhe i cili në qendrën e votimit vjen me letërnjoftim valid, komisioni zgjedhor është i obliguar t'ia mundësojë që pa pengesa të mbikëqyrë punën e komisionit zgjedhor në të gjitha fazat e punës së tij, duke filluar nga përgatitjet për hapjen e qendrës së votimit, e deri te verifikimi i rezultateve të zgjedhjeve.

(12) Shpenzimet e mbikëqyrjes së punës së organeve për zhvillimin e zgjedhjeve, i bartin propozuesit e listave të shpallura zgjedhore, anëtarët e të cilëve e mbikëqyrin punën e organeve për zhvillimin e zgjedhjeve.

### **Vëzhguesit vendorë**

#### **Neni 46.**

(1) Shoqatat e regjistruara të interesuara, objektivat e të cilave realizohen në fushën e zgjedhjeve dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të pakicave, të cilat duan të përcjellin punën e organeve për zhvillimin e zgjedhjeve, i paraqesin kërkesën Komisionit më së voni pesë ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve, në formularin që e përcakton Komisioni.

(2) Kërkesës i bashkangjiten ekstrakti nga Regjistri i Shoqatave dhe lista e personave që aplikojnë për vëzhgues të punës së organeve për zhvillimin e zgjedhjeve (vëzhguesit vendorë), në formularin që e përcakton Komisioni.

(3) Shoqata për vëzhgues mund ta paraqesë qytetarin e rritur të Republikës së Serbisë.

(4) Shoqata nuk mund ta paraqesë për vëzhgues kandidatin për anëtar të Këshillit Kombëtar ose anëtar të organit ose trupit, të angazhuar në zbatimin e zgjedhjeve.

(5) Për monitorimin e punës së Komisionit, shoqata mund të paraqesë më së shumti dy vëzhgues.

(6) Për monitorimin e punës së komisionit të caktuar zgjedhor, shoqata mund të paraqesë më së shumti një vëzhgues.

(7) Plotësimin e kushteve për monitorimin e punës së organeve të zgjedhjeve, kryetari e konstaton në seancën e Komisionit, në bazë të raportit të sekretarit të Komisionit.

### **Vëzhguesit e huaj**

#### **Neni 47.**

(1) Organizatat dhe shoqatat e interesuara ndërkombëtare dhe të huaja, që duan të monitorojnë punën e organeve për zhvillimin e zgjedhjeve, i paraqesin kërkesë Komisionit më së voni dhjetë ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve, në formularin që e përcakton Komisioni. Kërkesës i bashkangjitet edhe lista e personave që aplikojnë për vëzhgues të punës së organeve për zbatimin e zgjedhjeve (vëzhguesit e huaj), si dhe të përkthyesve të cilët do t'i shoqërojnë vëzhguesit e paraqitur në formularin e përcaktuar nga Komisioni.

(2) Kërkesën dhe listën nga paragrafi 1 i këtij neni, Komisioni, pa vonesë, ia dorëzon ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, për dhënien e mendimit, e cila është e obliguar që mendimin për kërkesën e paraqitur në Komision, ta japë brenda tri ditëve nga dita e marrjes së saj.

(3) Në rast të mendimit pozitiv të Ministrisë së Punëve të Jashtme, kryesuesi, bazuar në raportin e sekretarit të Komisionit, në seancën e Komisioni konstaton se organizatës apo shoqatës ndërkombëtare, iu është lejuar monitorimi i organeve për zbatimin e zgjedhjeve.

#### **Neni 48.**

(1) Përfaqësuesit e interesuar të vendeve të huaja që duan të ndjekin punën e komisioneve zgjedhore, i paraqesin kërkesë Komisionit, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, më së voni dhjetë ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve, në formularin që e përcakton Komisioni. Kërkesës i bashkangjitet edhe lista e personave që aplikojnë për vëzhgues të punës së komisioneve zgjedhore në zbatimin e zgjedhjeve (vëzhguesit e huaj), si dhe listën e përkthyesve të cilët do jenë të shoqëruar nga vëzhguesit e paraqitur, në formularin që e përcakton Komisioni.

(2) Ministria përgjegjëse për punët e jashtme, e përcjell kërkesën dhe listën nga paragrafi 1 i këtij neni, me mendimin e Komisionit, brenda tri ditëve nga dita e pranimit.

(3) Në rast të mendimit pozitiv të Ministrisë përgjegjëse për Punë të Jashtme, kryesuesi, bazuar në raportin e sekretarit të Komisionit, në seancën e Komisioni, konstaton se përfaqësuesve të shtetit të huaj iu është lejuar monitorimi i punës së komisioneve zgjedhore në zhvillimin e zgjedhjeve.

### **Autorizimi dhe akreditimi i vëzhguesve**

#### **Neni 49.**

(1) Pas konstatimit rreth përmbushjes së kushteve për monitorimin e punës së Komisionit, përkatësisht të komisioneve zgjedhore, Komisioni i lëshon paraqitësit të kërkesës autorizimin e duhur për monitorimin e punës së organeve për zbatimin e zgjedhjeve, ndërsa vëzhguesve vendorë dhe të huaj dhe përkthyesve akreditimin përkatës, në të cilat regjistrohen të dhënat e nevojshme nga lista e bashkangjitur me kërkesën.

(2) Shpenzimet për monitorimin e punës së organeve për zbatimin e zgjedhjeve, i bartin paraqitësit e kërkesave, vëzhguesit e të cilëve monitorojnë zgjedhjet.

### **Pozita e përfaqësuesve të propozuesve të listave zgjedhore dhe të vëzhguesve**

## Neni 50.

(1) Vëzhguesit, si dhe përkthyesit në përcjelljen e tyre, janë të detyruar që akreditimet t'i mbajnë në vend të dukshëm.

(2) Organet për zhvillimin e zgjedhjeve janë të obliguar që përfaqësuesve të propozuesve të listave zgjedhore, si dhe vëzhguesve dhe përkthyesve në përcjelljen e tyre, t'iu mundësojnë monitorim pa pengesa, përkatësisht monitorimin e çdo aktiviteti zgjedhor. Përkthyesi nuk ka të drejtë që në qendrën e votimit të qëndrojë i vetëm, pa vëzhgues në përcjelljen e të cilit është.

(3) Komisioni dhe komisionet zgjedhore janë të obliguar që në procesverbalet për punën e vet, të konstatojnë praninë e përfaqësuesve të propozuesve të listave zgjedhore dhe të vëzhguesve.

(4) Përfaqësuesit e propozuesve të listave zgjedhore dhe të vëzhguesve, janë të obliguar që të sillen sipas rregullave për ruajtjen e rendit në qendrën e votimit.

(5) Komisioni zgjedhor mund të largojë nga vendvotimi përfaqësuesit e propozuesve të listës zgjedhore, ose të vëzhguesve nëse nuk i përmbahen rregullave për ruajtjen e rendit në qendrën e votimit, nëse në vendin e votimit përdorin telefonin celular apo mjete tjera të komunikimit, e veçanërisht nëse në çfarëdo mënyre ndërhyjnë në punën e komisionit zgjedhor.

(6) Komisioni zgjedhor është i obliguar që për largimin e përfaqësuesit të propozuesit të listës zgjedhore apo të vëzhguesve, si dhe për arsyet për largim, ta informojë menjëherë Komisionin.

(7) Komisioni mund t'ia marrë autorizimin dhe akreditimin nëse vëzhguesi nuk sillet në kuadër të autorizimeve të tij.

## XIII. MJETET PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE

### Neni 51.

(1) Mjetet për zhvillimin e zgjedhjeve përdoren për:

- prokurimin, shtypjen dhe përkthimin e materialit zgjedhor,
- shpërblime për punën e anëtarëve të Komisionit,
- shpërblime për punën e anëtarëve të komisionit zgjedhor,
- shpërblime për punën e anëtarëve të trupave punuese,
- shpërblime për punën e administratave komunale/të qyteteve për kryerjen e punëve të përcaktuara me këtë Udhëzim,
- shpërblimet për punën e të punësuarve në Shërbimin e Kuvendit Popullor dhe personave të tjerë të angazhuar që për Komisionin të kryejnë punë profesionale dhe punë tjera në lidhje me zhvillimin e zgjedhjeve,
- shpërblimet për udhëtimet zyrtare të kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit, si dhe stafit në Shërbimin e Kuvendit Popullor dhe personave të tjerë, të angazhuar në lidhje me zhvillimin e zgjedhjeve në përputhje me dispozitat në fuqi,
- trajnime të anëtarëve të trupave punues dhe të komisioneve zgjedhore,

- përpunimin statistikor të rezultateve të votimit,
- blerjen e materialit për zyrë dhe materialit tjetër harxhues,
- shërbime të transportit, PTT, hoteliere dhe shërbime tjera.

(2) Urdhërdhënës për disponimin e mjeteve, janë kryetari i Komisionit, sekretari i Komisionit dhe zëvendësat e tyre.

#### XIV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

##### Neni 52.

Formularët për zbatimin e aktiviteteve zgjedhore, Komisioni i përcakton brenda pesë ditëve nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve.

##### Neni 53.

Ky Udhëzim hyn në fuqi në ditën e publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë”.

02 nr. 013-925/14

Në Beograd, 26 gusht 2014

**Komisioni Zgjedhor Republikan**

Zëvendëskryetari,

**Ivan Shebek, d.v.**